

**IMPACT OF SMALL BUSINESS DIFFICULTIES, IN ACCHEIVING COMPETITIVE
ADVANTAGE, WITH PARTICULAR EMPHASIS ON THE SITUATION OF THE
REPUBLIC OF MACEDONIA**

Arjeta Amzai

State University – Tetovo, Republic of Macedonia jeta_gaxi@yahoo.com

Aida Yzeiri Baftijari

State University – Tetovo, Republic of Macedonia aida_yzeiri@yahoo.com

Abstract: Given the importance of businesses in the world, economies everywhere are given special attention. Hence the concern for their delineation as appropriate, with the intention to create conditions for broader and more effective participation in economic activities in or involved. The role of small businesses is very critical for the economic development, social uplifting and political stability of every country. Businesses are diverse in nature. Businesses can be established for any kind of business activities in urban or rural area. Like everything else, the business environment itself varies by adapting to modern standards. Regardless of size, place of business, annual turnover, any business wherever it operates faces various difficulties affecting the achievement of the goal. The dynamic environment and complexity mean hyperchange, hipercompetition and hyperturbulence. The digital revolution, information age, the digital economy, the internet economy, web economy, knowledge-based society, a time of discontinuity, time of uncertainty are expressions that are familiar to the business so that it can achieve a competitive advantage. The rise in competition globally on the one hand, and the rapid development of information and communication technologies on the other hand, are forcing the businesses to change the way they operate. In terms of today's dynamic, heterogeneous and insecure surrounding, bussineses must be ready to cope with the difficulties that arise, so that they can prosper and survive. A sucessful business needs to overcome difficulties by discovering potential opportunities that will enable it to gain competitive advantage. It means that sucessful businesses can be those that can withstand the recent changes and adapt the tire activity thanks to the new entrepreneurial spirit incorporated in the business. Competitive advantage and the best position in the market reaches those businesses that create a similar performance or better than competitors, manage applying innovations, provide superior products and services that guarantee sucess and positive image for business. The purpose of this paper lies in the analysis of the difficulties that arise as a barrier to small businesses and finding ways to overcome them, with the sole purpose of achieving the best position on the market. Namely, the paper examines the impact of the challenges on the overall operation of businesses, in order to achieve competitive advantage.

Keywords: economic development, small businesses, difficulties, competition, competitive advantage.

**NDIKIMI I VESHTIRESIVE TE BIZNESEVE TE VOGLA NE ARRITJEN E AVANTAZHIT
KONKURRUES, ME THEKS TE VECANTE TE GJENDJES NE REPUBLIKEN E
MAQEDONISE**

Arjeta Amzai

Universiteti Shtetëror i Tetovës, Republika e Maqedonisë jeta_gaxi@yahoo.com

Aida Yzeiri Baftijari

Universiteti Shtetëror i Tetovës, Republika e Maqedonisë aida_yzeiri@yahoo.com

Abstrakt: Duke pasur parasysh rëndësinë e bizneseve të vogla në botë, ekonomitë e vendeve u kushtojnë rëndësi të madhe. Nga kjo lind edhe shqetësimi për përcaktimin e tyre një mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të krijohet kushte për pjesëmarrje më të gjërë dhe më efikase në aktivitetet ekonomike në të cilat ato janë të përfshira. Roli i bizneseve të vogla është kyc për zhvillimin ekonomik të vendit, ngritjen shoqërore dhe stabilitetin ekonomik të cdo vendi. Bizneset janë të ndryshme nga natyra. Ato mund të themelohen në çfarëdo aktiviteti biznesor, në hapsirë urbane ose rurale. Ashtu si cdo gjë tjetër edhe vet ambienti ku vepron biznesi ndryshon duke u përshtatur standardeve moderne. Pavarësisht nga madhësia, vendi ku operon biznesi, qarkullimi vjetor, cdo biznes kudo që vepron ballafaqohet me vështirësi të ndryshme të cilat ndikojnë në realizimin e qëllimit. Mjedisi dinamik dhe kompleks nënkupton ndryshime shumë të mëdha, konkurrencë shumë e madhe dhe shumë turbulente. Revolucionin digjital, epoka e informacionit, ekonomia e internetit, ekonomia e bazuar në dije, shoqëria e bazuar në njohuri, koha

e pasigurisë janë shprehjet me të cilat duhet të jet i njohur biznesi që të mund të arrijë avantazh konkurrues. Rritja në konkurrencën globale në njërin anë, si dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ndikojnë në ndryshimin e kahjes së operimit të bizneseve. Në kushtet e sotme dinamike, variabile dhe të pasigurta bizneset duhet cdoherë të jenë të gatshme për tu përballur me vështirësitë të cilat u paraqiten, që të mund të prosperojnë dhe mbijetojnë. Një biznes i suksesshëm cdoherë duhet të mundohet t'i tejkalon vështirësitë, duke zbuluar mundësi potenciale, të cilat do t'i mundësojnë që të arrijë avantazh në treg. Do të thotë se mund të jenë të suksesshme vetëm ato biznese të cilat mund të ju bëjnë ballë ndryshimeve bashkëkohore dhe të përshtatin aktivitetin e tyre falë frymës së re sipërmarrëse të inkorporuar në biznes. Avantazh konkurrues dhe pozicion të mirë në treg arrijnë vetëm ato biznese që krijojnë performancë të ngjajshme ose më të mirë se konkurrenca, aplikojnë inovacione dhe ofrojnë produkte dhe shërbime superiore të cilat garantojnë sukses dhe imazh pozitiv për biznesin. Qëllimi i këtij punimi qëndron në analizën e vështirësive të cilat paraqiten si pengesë e bizneseve të vogla, dhe gjetjen e mënyrave për tejkalimin e tyre, me të vetmin qëllim për të arritur pozicion sa më të mirë në treg. Kryesisht, ky punim analizon ndikimin e vështirësive në gjithë aktivitetin biznesor, me qëllim për të arritur avantazh konkurrues.

Fjalë kyce: zhvillimi ekonomik, bizneset e vogla, vështirësitë, konkurrenca, avantazhi konkurrues.

1. HYRJE

Rrethina e paqartë, ndryshimet dinamike në veprimtarinë bashkëkohore, si konkurrenca globale rritëse, internacionalizimi i bizneseve, ndryshimet strukturore dinamike dhe rritja e pasigurisë shkaktojnë nevojën për zhvillim sa më të madh të bizneseve të vogla. E dime se, bizneset e vogla japin kontribut të madh për zhvillimin ekonomik të vendit, ngritjen sociale dhe stabilitetin ekonomik të cdo vendi. Për shkak të rëndësisë së madhe që e kanë në drejtim të zhvillimit të ekonomisë, atyre u jepet përkrahje e madhe si nga ana e qeverisë ashtu edhe nga ana e institucioneve, agjensive të ndryshme me qëllim të krijimit të kushteve sa më të volitshme për realizimin e veprimtarisë së tyre, detektimin e shkaqeve të humbjes në fazën e hershme si dhe orientimin e tyre drejt inovacioneve, si dhe dhënien e këshillave të shumta që të mund bizneset të ngjiten drejt suksesit. Pavarësisht nga vendi, bizneset e vogla përballen me vështirësi të njëjta sa i përket mbijetesës së tyre dhe pozicionit të cilin dëshirojnë ta arrijnë në treg. Ato shpesh përballen me papërsosshmërinë e tregut, gjithashtu mund të ballafaqohen me probleme dhe vështirësi në lidhje me marrjen, ose sigurimin e kapitalit ose kredisë, vecanërisht në fazën e fillimit-themlimit të biznesit të ri. Burimet financiare të tyre të pakta, mund gjithashtu të kontribuojnë në zvogëlimin e qasjes së tyre në teknologji dhe inovacione të reja. Edhe pse u përmendën disa prej vështirësive me të cilat ballafaqohen pronarët e bizneseve të vogla, si më të shpeshta mund të cekën (Burmajster, A., 2010, pp.1-2) :

1. Vështirësitë për t'i mbajtur konsumatorët e njëjtë, si dhe për të tërhequr konsumatorë të rinj dhe cilësor.
2. Punësimin e stafit i cili do të kontribuojë që biznesi juaj të jetë i suksesshëm dhe të rritet
3. Burime financiare të pamjaftueshme, të cilat shkaktojnë shkarkimin e punonjësve, reduktimin e beneficioneve për punonjësit, rritjen e orarit të punës.
4. Shitje negative. Ky është faktor kyç për një ndërmarrje që të mbijetojë dhe rritet.
5. Menaxhimi joefektiv. Në qoftë se pronari i biznesit nuk fokusohet mjaftueshëm në rolin e tij si udhëheqës, ajo do të ndikojë negativisht në biznesin dhe do ta çon atë kah dështimi.
6. Mungesa e planit të qartë.
7. Menaxhimi joefikas i kohës.

Mirëpo nga këndvështrimi tjetër, bizneset e vogla hapërojnë me një grup të dallueshëm të përparësive. Shkathtësia dhe përgjishmëria ndaj rrethanave të zhvendosura është një e mirë tjetër me të cilën mund të mburen pronarët e bizneseve të vogla. Këto dhe përparsitë tjera të njohura për bizneset e vogla duhet t'i shfrytëzojnë pronarët për t'i tejkaluar vështirësitë të cilat paraqiten gjatë realizimit të aktivitetit biznesor.

2. RISHIKIM I LITERATURES

Pavarësisht nga madhësia, shumica e bizneseve përballen me shumë vështirësi të njëjta çdo ditë. Maksimizimi i fitimit, minimizimi i shpenzimeve dhe gjetja e stafit të talentuar për të mbajtur gjërat nën kontroll dhe në kahjen e duhur janë një ndër problemet kyçe shkruan (Rampton, J.) Përderisa përfitimi është gjithmonë i rëndësishëm, prap se prap duket se është më tepër një fokus i bizneseve më të vogla sesa i atyre më të mëdha. Sa i përket punësimit, ai paraqitet si vështirësi më e madhe për 56% të bizneseve me 101-499 punonjës, dhe gjithashtu do të vazhdon të përjetohet si pengesë edhe në vitet e ardhshme. Bizneset e mëdha, ndërkohë, mendojnë për vështirësitë në drejtim të rritjes së bazës së konsumatorëve dhe trajtimit të çështjes lidhur me burimet njerëzore. (Stanleigh, M.) në punimin e tij potencon rolin e rëndësishëm që e kanë analistët e biznesit si një pasuri e pacmuar dhe se bizneset duhet të

investojnë për trajnimin dhe zhvillimin e këtij roli. Ky autor sugjeron fuqimisht nevojën për të trajnuar analistët e biznesit në procesin e analizës së kërkesave ndryshme të biznesit. Rregullimi i qeverisë paraqitet si vështirësi sapo biznesi të rritet prej 51-100 punonjës. Një sondazh (**Gallup 2014**) zbuloi se sa mbizotëruese janë këto sfida, nga pronarët e bizneseve vazhdimisht kërkohet të përshtasin sjelljet e tyre për të siguruar pajtueshmërinë rregullatore. Kjo përfshin ligjet që lidhen me sigurimin e të dhënave të konsumatorëve dhe shqetësuese për ndikimin e një rritjeje minimale të pagës në operacionet e tyre. Derisa bizneset rriten, pajtueshmëria qeveritare duket se zë një pjesë më të madhe të kohës së liderëve të tyre. (**Ewer, T.,**) shkruan për gjashtë vështirësi të cilat paraqiten si pengesë në veprimtarinë e bizneseve dhe për të cilat duhet të gjenden mënyra se si të tejkalohen. Njëra ndër vështirësitë të cilat i numëron është gjetja dhe mbajtja e konsumatorëve profitabil nëpërmjet identifikimit të asaj pike unike të shitjes, identifikimin e kërkesave të konsumatorëve të rinj. Përveç pagës të cilën e marrin punonjësit ato kanë nevojë për një atmosferë relaksuese në punë, të mund të komunikojnë dhe flasin lirshëm me menaxhmentin. Kjo nuk duhet të merret si opsion, por si një domosdoshmëri në brendinë e bizneseve, sepse njëra ndër arsytet më të shpeshta të qarkullimit të lartë të stafit është moskujdesi i menaxhmentit për nevojat e punonjësve. Shpenzimet janë gjithashtu një nga vështirësitë e shpeshta, sepse bizneset lejojnë të bëhen shpenzime të panevojshme, të cilat mund ta drejtojnë biznesin drejt falimentimit. Problemet e parasë në format e tyre të ndryshme janë në krye të vështirësive dhe për bizneset shqetësimet kryesore janë konsumatorët që pengojnë pagesat, pagesat e papritura dhe faturat e papaguara që nuk presin që të paguhet. Sipas (**Johannson A.,**) në kohën bashkëkohore paraqiten disa top vështirësi të cilat kaplojnë bizneset. Punësimi i punonjësve të rinj është vështirësi me të cilën bizneset e sotshme duhet të përballen. Për bizneset me 5 deri 10 punonjës rritja e fitimit është sfida më e madhe. Tjetër sfidë përmendet edhe sigurimi i kujdesit shëndetësor për punonjësit. Menaxhimi i rrjedhës së parave edhe pse paraqitet si vështirësi është kryesisht i shërueshëm duke gjetur një person të përshtatshëm, i cili atë detyrë do ta realizon në mënyrën më të mirë. Qëndrimi i energjizuar dhe tejkalimi i lodhjes nga puna e pandalshme, janë gjithashtu një ndër problemet e shumta për pronarët e bizneseve të vogla, e cila lodhje mund të çojë në vendime të nxituara për biznesin, duke përfshirë edhe dëshirën për ta braktisur plotësisht. Për shumë biznese të vogla, vecanërisht ato që kanë më pak se 10 punonjës, varësia e konsumatorit është një çështje e madhe. Nëse një biznes varet nga një konsumator i vetëm për më shumë se gjysmën e të ardhurave të saj, për këtë çështje duhet të ngritet një flamur i kuq i madh. Diverzifikimi i bazës së konsumatorëve, duhet të jetë një prioritet nëse rritja dhe stabiliteti janë qëllime të biznesit.

3. ANALIZA EMPIRIKE

Në anketën e realizuar janë të përfshira gjithsej 50 ndërmarrje nga Republika e Maqedonisë. Përzgjedhja e mostrës është e rastësishme dhe norma e përgjigjes së pyetësorëve është 100%. Anketa është realizuar me shkrim dhe në mënyrë direkte.

Në pyetjen e parashtruar se sa janë të njoftuar punonjësit me vështirësitë me të cilat ballafaqohet biznesi, nga **grafiku nr.1** mund të vërehet se 40% të të anketuarve janë përgjigjur se janë mesatarisht të njoftuar me vështirësitë, 12% se janë shumë pak të njoftuar dhe 26% se nuk janë aspak të njoftuar.


Grafiku nr.1



Nga grafiku në vijim (**grafiku nr.2**) mund të shihet se numri më i madh i të anketuarve (55%) rangojnë më së larti ndikimin e vështirësive në suksesin e biznesit, që do të thotë se një biznes i cili nuk mund të përballtet me


vështirësitë të cilat i paraqiten, ai biznes e ka të vështirë të arrin avantazh konkurrues. Vetëm 4% janë përgjigjur se vështirësitë me të cilat ballafaqohet biznesi nuk kanë aspak ndikim në suksesin e tij.

Grafiku nr.2




Teknologjia sa më e sotifikuar ndikon në realizimin e qëllimit të biznesit në mënyrë të suksesshme, duke i mundësuar biznesit të redukton kostot e prodhimit dhe të tregohet konkurrent në treg me produkt më të cilësuar. Në grafikun e mëposhtëm (**grafiku nr.3**) shihet se 46% e të anketuarve janë përgjigjur se në biznesin e tyre përdoret teknologji tradicionale, 36% teknologji e përshtatshme dhe 18% janë përgjigjur se përdoret teknologji e përditsuar.

Grafiku 3



Dihet se cdo biznes, pa marr parasysh madhësisë, qëllimit që e realizon, hapsirën ku vepron ballafaqohet me vështirësi të ndryshme. Sa më lehtë dhe më shpejtë biznesi përballet dhe i tejkalon ato vështirësi aq më shpejt tregohet konkurrent në treg. Në **grafikon nr.4** janë dhënë disa nga vështirësitë e shumta të cilat paraqesin pengesë në afarimin e biznesit. 35% të të anketuarve sistemin e korruptuar dhe gjykatën jo transparente e vlersojnë si vështirësi më të madhe me të cilën përballen bizneset në Republikën e Maqedonisë. Pastaj, 25% rangojnë në vend të dytë barrierat administrative si pengesë mjaft e rëndësishme në suksesin e biznesit. Mungesa e stafit të kualifikuar gjithashtu paraqitet si pengesë me të cilën vështirë përballen bizneset e vogla (20%). Dhe më poshtë si vështirësi më pak të rëndësishme për bizneset e vogla në R. e Maqedonisë rangohen tregu i vogël (10%), infrastruktura jo e zhvilluar mirë (5%), si dhe numri i pamjaftueshëm i menaxherëve të aftë për udhëheqjen e bizneseve transnacionale (5%).

Grafiku 4



4.PERFUNDIMI

Mënyra moderne e funksionimit të ekonomive kërkon një numër të reformave që duhet të bëhen. Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe vet biznesi është diçka që ndryshon dhe përshtatet me standardet moderne. Nuk mund të presim që të jemi konkurrues në treg nëse shesim një produkt që askush nuk e blen. Kur krijimi i mjedisit të biznesit është i njëjtë, ne nuk mund të presim investime dhe nisje biznesi nëse nuk ofrojmë një mjedis modern të biznesit. Për çdo sipërmarrës të ardhshëm, gjëja më e rëndësishme është procesi i konvertimit jo të idesë në kapital, sa lehtë kjo varet nga shteti, sa i mundëson sipërmarrësit ta kryejnë me sukses këtë transferim. Kushtet për të bërë biznes në një ekonomi është vendimtare për mirëqenien e qytetarëve në atë vend. Në çdo shtet, bizneset përballen me faktorë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë që ndikojnë drejtpërdrejt në suksesin e tyre. Pikërisht faktorët indirektë, ku një biznes nuk ka një ndikim të madh, duhet të përbëjë një sfidë për çdo ekonomi kombëtare. Nëse nuk ka përparim biznesi në një shtet, nuk do të ketë as kontributi i tij ndaj PBB-së dhe zvogëlimi i papunësisë. Bizneset e vogla dhe të mesme varen nga ndryshimet e shtetit, por shteti varet nga rritja dhe ndryshimet në bizneset e vogla dhe të mesme, ato janë të ndërlidhura dhe duhet të jenë të vetëdijshme për këtë. Nëse nga fillimi sipërmarrësi ka hasur problem me regjistrimin e biznesit, marrjen e licencave dhe aprovimet nuk mund të presim që në një mjedis të tillë biznesi të ketë mjaft hapësirë për përmirësim. Por kushdo që dëshiron të investojë ose të fillojë një biznes nuk ka informacionin e nevojshëm. Ndonjëherë, transparencja dhe mungesa e informacionit nënkupton likuidimin e biznesit. Kjo është arsyeja pse Banka Botërore për 11 vjet përmes raportit të Doing Business po punon për të zbuluar të gjithë informacionin e nevojshëm për investime në 189 ekonomi. Në fillim këto ishin vetëm një informacion dhe ekonomitë nuk bënë asgjë për të përmirësuar vlerësimin e saj. Por me faktin se Doing Business po fillon të përdoret nga të gjithë investitorët e mundshëm, tani ky raport po bëhet i dyanshëm dhe shumë më i përdorur nga vendet si një mjet për të përmirësuar lehtësinë e bërjes së biznesit. Maqedonia ka qenë në një situatë që nga fillimi i saj reforma duhej bërë pothuajse në të gjitha segmentet e funksionimit të saj. Një proces që kërkon kohë dhe ekspertizë. A jemi tashmë në kontakt me ekonomitë moderne dhe nëse po bëjmë këto reforma më së miri janë raportet nga institucionet përkatëse më të dëgjuarit. Këto raporte formohen në bazë të hulumtimeve tërësore në vend. Raporti i Bërjes së Biznesit i përgatitur nga Banka Botërore është një nga udhëzuesit e qeverisë maqedonase për atë që ka ndryshuar dhe çfarë duhet ndryshuar. Kur nuk dimë nëse po bëjmë përparim, është më mirë të krahasojmë. Kur bëhet fjalë për Doing Business, nëse e krahasojmë atë me ekonomitë e tjera botërore, do të arrijmë në përfundimin se ne po ecim me një ritëm më të shpejtë. Pas të gjithave, për disa vite tani, ne jemi reformatori më i madh i vendit në botë. Por kur themi këto fakte duhet të kemi parasysh se ky raport mat vetëm 11 tregues. Nëse këto 11 tregues janë vendimtarë për fillimin e një biznesi? Sigurisht jo, këto janë tregues që janë me rëndësi të madhe, por me reformën e tyre ne nuk i kemi zgjidhur të gjitha problemet. Kemi probleme në infrastrukturë, mungesë të burimeve njerëzore, mospërputhje në ligje, korrupsion dhe institucione partizane. Kjo nuk mund të matet, por ka një ndikim vendimtar kur vendos të fillojë një biznes. Përveç të gjitha gjërave që shteti duhet të bëjë për të përmirësuar klimën e biznesit, ka gjëra të

panumërta që vetë sipërmarrësit mund të bëjnë. Kjo ka për qëllim të pasurojë njohuritë rreth sipërmarrjes dhe të forcojë aftësitë për të udhëhequr biznesin. Kushdo që fillon një biznes nuk mund ta vendosë atë në një sipërmarrës, kushdo që nis një biznes dhe vendos një qasje të re dhe një mënyrë për ta bërë atë, ai bëri hapin e parë në sipërmarrjen. Kultura sipërmarrëse është diçka që nuk e kishim më parë, por kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet ta futim atë dhe të jemi pjesë e kulturës sonë të biznesit. Pjesëmarrja në trajnime, seminare, konferenca. Trajnimet mund të ndryshojnë shumë në mënyrën se si ne mendojmë dhe shikojmë në një biznes, kështu që së bashku me reformat dhe ndihmën shtetërore ne mund të ndërtojmë një biznes që do të shërbejë si një shembull për sipërmarrësit e ardhshëm.

LITERATURA E SHFRYTEZUAR

1. Atsede Woldie (UK), Patricia Leighton (UK), Adebimpe Adesua (UK), Factors influencing small and medium enterprises (SMEs): an exploratory study of owner/manager and firm characteristics, 2008.
2. Achtenhagen L., Naldi L., Research on Small Firm Growth: A Review: Brisbane Graduate School of Business, Queensland University of Technology, Gardens Point, Brisbane 4001 QLD, Australia, 2007.
3. Achtenhagen L., Research on Small Firm Growth: A Review, Jönköping, 2007.
4. Ball J. K. , Microequity: A new model for microfinance in the U.S. , University of Central Florida , Orlando, Florida ,Fall 2012.
5. Churchill, N.C ,.Lewis V. L, The five stages of small business growth, Harvard Business Review, 1983.
6. Prof. dr. Avlijaš R., Preduzetništvo i menadžment malih i srednjih preduzeća, Beograd, 2008.
7. Porter, M.E., Competitive advantage, first free press edition New York, 1985, pp.13-28.
8. Mr Avlijaš R., Istraživanje I unapređenje faktora uspešnosti preduzetništva I menadžmenta malih I srednjih preduzeća, Novi Sad, 2006.
9. Stanworth & Purdy, SME Facts & Issues, A Compilation of Current Data & Issues on U.K. Small & Medium-sized Firms, UK, 2008.
10. Sydney Media Jam.com, The ultimate survival skill, 2012.
11. Tošović-Stevanović Aleksandra, Konkurentske prednosti i inovacije, Zaduzbina Andreević, Beograd, 2009.
12. Vujić Dobrila, Menadžment ljudskih resursa i kvalitet: ljudi - ključ kvaliteta i uspeha, Centar za primenjenu psihologiju, Beograd, 2008.
13. Zakic, N.; Jovanovic, A.; Stamatovic, M.; External & Internal Factors Affecting the Product & Business Process Innovation, Economics & Organisation, 2008, pp.17-29.